

## **AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

### **THIRRJE PËR REKRUTIM EKSPERTËSH TË JASHTËM**

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), referuar nenit 19, pika c) të Ligjit 97/ 2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i cili parashikon se AMA, përveç funksioneve të tjera: “...realizon, organizon, mbështet dhe promovon kërkimin në lidhje me çështjet e mediave audiovizive”, kërkon të organizojë një tryezë diskutimi mbi “Gjuhën e urrejtjes në mediat audiovizive” me ekspertë të kësaj fushe, Ofrues të Shërbimit të Medias Audiovizive (OSHMA), si dhe përfaqësues nga AMA.

Autoriteti Kontraktues (AMA) kërkon të rekrutojë deri në 8 (tetë) ekspertë të jashtëm, të kualifikuar të fushës së medias dhe komunikimit, të cilët do të prezantojnë gjetjet e studimeve të tyre gjatë aktivitetit.

#### **TERMAT E REFERENCËS**

##### ***Objektivi***

Tryeza e diskutimit “Gjuha e urrejtjes në mediat audiovizive” është planifikuar nga Këshilli i Ankesave për të evidentuar fushat ku shfaqet më shumë gjuha e urrejtjes dhe të mekanizmave për minimizimin ose parandalimin e saj. Pikëpamjet dhe gjetjet e ekspertëve do të jenë në fokus të Tryezës së diskutimit.

##### ***Detyrat***

Ekspertët do të punojnë në bashkëpunim me Këshillin e Ankesave për realizimin e termave të referencës si më poshtë:

- Realitetin e mediave audiovizive, natyrën dhe shtrirjen e gjuhës së urrejtjes në ditët tona;
- Vetë-rregullimin dhe moderimin i programeve audiovizive si mjete për trajtimin dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes;
- Perspektivën e mediave audiovizive;
- Natyrën e programeve audiovizive për grupmoshat e reja dhe gjuha e urrejtjes;
- Detajet që nxisin stereotipa dhe urrejtje tek audiencat në lajmet e kronikës;
- Etikën midis përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe dëshirës për audiencë;
- Gjuhën e urrejtjes si komunikim politik;
- Kodin e Transmetimit dhe stereotipet me bazë gjinore në televizionet lokale.

Gjetjet dhe problematikat e studimeve të tyre ekspertët do t’i prezantojnë gjatë Tryezës, ndërsa një kopje elektronike dhe të printuar do ta dorëzojnë në fund të aktivitetit në AMA.

##### ***Kriteret***

- Të zotërojnë diplomën e shkollës së lartë në fushën e medias dhe komunikimit. Kualifikimet të tjera në këto fusha do të përbëjnë avantazh;
- Të paraqesin në gjuhën shqipe Abstraktin mbi studimin në lidhje me referimin që do të mbahet gjatë Tryezës;
- Të jenë shtetas shqiptar;

***Dokumentacioni që duhet të dorëzohet pranë AMA-s***

- Jetëshkrim (CV)
- Kopje ID/Pasaportë
- Kopje të diplomës së shkollës së lartë
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë,
- Abstraktin mbi studimin.

### ***Mënyra e vlerësimit të kandidatëve***

Kandidatët do të vlerësohen për dokumentacionin, përkatësisht për jetëshkrimin (30 pikë), trajnimet apo kualifikimet dhe arsimime shtesë të lidhura me fushën (20 pikë), abstrakti 50 Totali i pikëve për vlerësimin është 100 pikë.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Ankesave, do të shpallë fituesit në faqen zyrtare të AMA-s. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike rezultatet e tyre.

### ***Pagesa***

Për këtë angazhim, ekspertët e jashtëm do të paguhën me 20.000 (njëzet mijë) lekë.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 24 Tetor 2018, pranë Zyrës së Arkiv Protokollit në AMA.

Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II", Tiranë

APLIKIMET HAPEN MË 25 tetor 2018.